

Këshilli Akademik i Akademisë "Evolucion", në ushtrim të përgjegjësive të tij sipas Statutit dhe akteve të brendshme që rregullojnë studimet Bachelor dhe Master, në mbledhjen e mbajtur më 30.09.2025, vendosi si në vijim:

VENDIM

Lidhur me mundësinë e shtyrjes së afatit për përmbylljen e studimeve për studentët që kanë tejkaluar kohëzgjatjen standarde të studimeve.

1. Studentëve të programeve bachelor me kohëzgjatje tre (3) vite, të regjistruar në vitin akademik 2018/2019, të cilët kanë përfunduar të gjitha provimet e viteve paraprake dhe kanë ndjekur procesin mësimor të vitit të fundit, u mundësohet përmbyllja e studimeve deri më 30.09.2026.
2. Studentëve bachelor të regjistruar para vitit akademik 2018/2019, të cilët kanë përmbyllur të gjitha detyrimet akademike në programet që përfundojnë me temë diplome, u lejohet përfundimi i procesit të diplomimit brenda afatit 30.09.2026. Për ata që ndjekin programe pa temë diplome dhe kanë mbetur me maksimum dy provime të vitit të fundit, u lejohet përfundimi i studimeve në të njëjtin afat.
3. Studentëve të studimeve master, të regjistruar në vitin akademik 2020/2021, që kanë tejkaluar kohëzgjatjen e paraparë dhe kanë realizuar së paku gjysmën e provimeve, si dhe kanë qenë aktivë në paraqitje provimesh gjatë vitit akademik 2025/2026, u jepet mundësia e përfundimit të studimeve deri më 30.09.2026.
4. Studentëve të studimeve master të regjistruar para vitit akademik 2020, të cilët kanë përfunduar obligimet e vitit të parë dhe kanë qenë aktivë në paraqitje provimesh gjatë vitit 2025/2026, u mundësohet përmbyllja e studimeve brenda afatit të njëjtë.
5. Studentëve master që kanë përfunduar të gjitha provimet, ose kanë mbetur me detyrime të pakta akademike, u lejohet vazhdimi i procesit të diplomimit, përfshirë paraqitjen e provimeve dhe mbrojtjen e temës, deri më 30.09.2026.
6. Studentët që kanë tejkaluar kohëzgjatjen e studimeve, por nuk kanë përmbyllur detyrimet kryesore në programet që përfundojnë me diplomë dhe për të cilat nuk ofrohet më programi përkatës, nuk përfshihen në këtë vendim.

7. Studentëve që nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara më sipër, por vazhdojnë të jenë të regjistruar në vitet përkatëse të studimit, u jepet mundësia të vazhdojnë studimet sipas planeve të reja mësimore, pa procedura të reja aplikimi.
8. Koha gjatë së cilës studenti ka pasur status të pezulluar, sipas dispozitave përkatëse, nuk llogaritet në kohëzgjatjen totale të studimeve.
9. Strukturat akademike përkatëse obligohen të sigurojnë njoftimin dhe publikimin e këtij vendimi për studentët.
10. Zbatimi i këtij vendimi mbetet në përgjegjësinë e menaxhmentit të institucionit dhe bartësve të proceseve akademike.
11. Ky vendim bëhet publik në ambientet dhe kanalet zyrtare të Akademisë.
12. Vendimi hyn në fuqi në ditën e miratimit.

Kryetari i Këshillit Akademik
Prof. Flora Loshi

